



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. 324/17 Prot.

Pogradec, më 02.02.2026

VENDIM

Nr. 13, datë 29.01.2026

**“PER NJE NDRYSHIM NË VKB NR .148 DATË 22.12.2028 TË KËSHILLIT
BASHKIAK, “ PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE Z. RUDI TOLLOZHINA,
FAMILJE QË KA PËSUAR DËME NË ORENDI/PAJISJE ELEKTROSHTËPIAKE SI
PASOJË E PËRMBYTJES”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 29, pika 1, nenit 54 dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 30 gërma “gj”, të Ligjit nr. 45, datë 18.07.2019, “Për mbrojtjen civile”, Kreut III, pika 1, shkronja “ë”, të V.K.M nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I:

1. Të akordojë ndihmën financiare për z. Rudi Tollozhina, shumën prej **45890** (Dyzet e pese mijë e teteqind e nentedhjetë) Lekë, familje që ka pësuar dëme në orendi/pajisje elektroshtëpiake si pasojë e përmbytjeve në banesë nga rënia e shirave të rrëmbyeshëm.
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga komisioni përkatës pranë Bashkia Pogradec.
3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i pikës 1, të këtij vendimi, të përballohen nga Fondi i Emergjencave Civile, të parashikuar në Buxhetin e vitit 2026, të Bashkisë Pogradec.



4. Ndihma financiare që do të akordohet, do të përdoret për t'i ardhur në ndihmë familjes së shtetasit Rudi Tollozhina, banesa e të cilit është dëmtuar nga rënia e shirave të rrëmbyeshëm.
5. Ngarkohen Drejtoria e Emergjencave, Strehimit, Shpronësimeve, Titujt e Pronësive, Administrimit tokës Bujqësore dhe Sherbimeve si dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Menaxhimit Financiar, pranë Bashkisë Pogradec, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar

KRYETARE E KËSHILLI
Manjola KAMOLLI

1. Miratuar me 23 vota

2. Vota Pro 23

3. Vota Kundër 0

4. Vota Abstenim 0

5. Zbardhur më date 29.01.2026

